

Mundësi për aplikim të bashkive në thirrjen "BeMed Call for Micro-Initiatives (CMI)"

Synimi i Thirrjes:

Beyond Plastic Med, ose shkurt "BeMed", është një shoqatë nga zona e Monako-s në Francë, e angazhuar për reduktimin e ndotjes plastike në Mesdhe. BeMed ka dy lloje thirrjesh: Thirrje për grante të vogla "Call for Micro-Initiatives" (CMI) dhe thirrjet për grante të mëdha "Call for Projects in the Mediterranean Islands" (CPMI). Thirrja e hapur është thirrja e granteve të vogla. Kjo thirrje synon të mbështesë iniciativat lokale në vendet e Mesdheut për të luftuar ndotjen plastike dhe për të promovuar praktika të qëndrueshme. Ajo synon të forcojë kapacitetet e aktorëve lokalë dhe të përhapë praktika të mira në reduktimin e përdorimit të plastikës, implementimin e alternativave dhe menaxhimin efektiv të mbetjeve plastike. Qëllimi përfundimtar është krijimi i një rrjeti aktorësh të përkushtuar që kontribuojnë në një Mesdhe më të pastër dhe më të shëndetshëm.

Objektivat e veprimit të thirrjes:

- Ndryshimet në sjelljen sociale në lidhje me përdorimin e paqëndrueshëm të plastikës,
- Përforcimi i kapaciteteve të palëve lokale të interesit,
- Shpërndarja e praktikave të mira për reduktimin e përdorimit të plastikës, zbatimin e produkteve alternative dhe menaxhimin e mbetjeve plastike,
- Të krijojë një rrjet mesdhetar të aktorëve lokalë të angazhuar për të luftuar ndotjen plastike.

Tema të Pranueshme:

- Rritja e ndërgjegjësimit dhe shpërndarja e informacionit,
- Mbështetja e zbatimit të rregulloreve,
- Hulumtimi dhe mbledhja e të dhënave,
- Bashkimi dhe mobilizimi i palëve të interesuara,
- Ripërdorimi dhe gjetja e alternativave ndaj plastikës,
- Përmirësimi i sistemeve të grumbullimit dhe menaxhimit të mbetjeve plastike.

Kush mund të aplikojë dhe çfarë konsorciumi pranohet:

- Entitetet nga vendet përreth Mesdheut, me prioritet për **Shqipërinë, Algjerinë, Egjiptin, Libanin, Marokun, Malin e Zi, Tunizinë, Turqinë.**
- Entitetet që janë mbështetur dy herë nga thirrjet e mëparshme të BeMed për mikro-iniciativa nuk mund të mbështeten përsëri.
- Entitetet që kanë një projekt në vazhdim të mbështetur nga BeMed nuk janë të pranueshme.
- Një entitet mund të paraqesë vetëm një aplikim në këtë thirrje.
- Të zhvillojnë aktivitete të fokusuara kryesisht në ndërgjegjësimin, mbrojtjen e natyrës, lobimin mjedisor, ndryshimet shoqërore, kërkimin dhe inovacionin.
- Të bëjnë pjesë në një nga kategoritë e mëposhtme: **autoritet vendor, bashki, OJF, shoqatë, shoqëri nën 20 punonjës, institucion shkencor.**
- Të kenë një status ligjor që u mundëson atyre të marrin grante.
- Të kenë zyrën e tyre qendrore të regjistruar në vendin që përfiton nga granti.
- Aplikimet nga institucionet që nuk kanë marrë mbështetje financiare nga BeMed do të kenë përparësi.

Aktivitete të pranueshme:

- **Reduktimi, ripërdorimi dhe gjetja e alternativave ndaj plastikës:** Eliminimi i përdorimit të vetëm, dhënia e një jetë të dytë plastikës dhe zhvillimi i mënyrave alternative për të kufizuar prodhimin dhe/ose përdorimin e plastikës

- **Përhapja e fjalës:** Rritja e ndërgjegjësimit të publikut dhe institucioneve lidhur me burimet dhe pasojat e ndotjes plastike.
- **Krijimi i rekomandimeve dhe rregulloreve të reja:** Mbështetja për zbatimin e tyre.
- **Eksperimente dhe mbledhje e të dhënave:** Mbledhja e të dhënave dhe studimet në lidhje me burimin e plastikës dhe ndikimet e tyre. Studime socio-ekonomike mbi varësinë prej plastikës.
- **Mblidhje partnerësh dhe mobilizime:** Aktivitete që gjenerojnë sinergji midis aktorëve të ndryshëm (përfshirë sektorin privat) të përfshirë në plastikë me qëllim lehtësimin e zbatimit të zgjidhjeve konkrete për të luftuar ndotjen plastike.
- **Sisteme të përmirësuara për mbledhjen dhe përpunimin e mbetjeve plastike.**

Cili është buxheti i thirrjes për secilën iniciativë:

- Financimi maksimal: **10,000 EUR** (nuk duhet të jetë më shumë se 70% të kostos totale të projektit).
- Bashkëfinancimi minimal: **30%** nga aplikanti ose partnerë të tjerë.

Si bëhet aplikimi:

- Aplikimi bëhet përmes plotësimit të formularit të aplikimit dhe të formularit të buxhetit (në anglisht ose frëngjisht).
- Dërgimi i aplikimit të bëhet në adresën elektronike: **ami@beyondplasticmed.org**

Kur është afati i fundit:

- 6 janar 2025, ora 23:00 (Ora e Parisit GMT+1)

Linku i Thirrjes:

<https://www.beyondplasticmed.org/en/call-for-projects>

Për më shumë detaje ose ndihmë në përgatitjen e aplikimit, jemi në dispozicion!